



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19 Prill 2023

Nr: 389

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 187, 188, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 202, 203, 204, 205, 206, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ KRYETARËVE TË DISA BASHKIVE, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 19 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBEKT: Kryetari i bashkisë Cërrik, z. Andis Salla;
Kryetari i bashkisë Delvinë, zj. Majlinda Qilimi;
Kryetari i bashkisë Dibër, z. Rahim Spahiu;
Kryetari i bashkisë Fier, z. Armando Subashi;
Kryetari i bashkisë Fushë-Arrëz, z. Fran Tuci;
Kryetari i bashkisë Gjirokastrë, z. Flamur Golemi;
Kryetari i bashkisë Gramsh, z. Klodian Taçe;
Kryetari i bashkisë Himarë, z. Jorgo Goro;
Kryetari i bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli;
Kryetari i bashkisë Klos, z. Ilmi Hoxha;
Kryetari e bashkisë Kurbin, zj. Majlinda Cara;
Kryetari i bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu;
Kryetari i bashkisë Mat, z. Agron Malaj;
Kryetari i bashkisë Memaliaj, z. Gjolek Guci;
Kryetari i bashkisë Patos, zj. Rajmonda Balilaj;
Kryetar i bashkisë Përmet, zj. Alma Hoxha;
Kryetari i bashkisë Sarandë, z. Adrian Gurma;
Kryetari i bashkisë Shkodër, z. Bardh Spahia;
Kryetari i bashkisë Tropojë, z. Rexh Byberi;

Data: 19 Prill 2023

Nr: 389

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

Kryetari i bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për publikimin e së paku 48 (dyzet e tetë) postimeve me përmbajtje elektorale, nga 20 (njëzet) kryetarë bashkie, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të bashkive dhe të kryetarëve të bashkive, përbëjnë përdorim të institucionit në funksion të partisë politike.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 20 (njëzet) denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Data: 19 Prill 2023 Nr: 389
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, ndaj kryetarëve të disa bashkive, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Denoncuesi ka paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1- Denoncimi regjistruar me nr. **187 ID -Kryetari i bashkisë Cërrik z. Andis Salla**”, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Cërrik”, ka postuar takimin e tij dhe të drejtuesit politik të qarkut Elbasan z. Damian Gjikhuri, me strukturat e Partisë Socialiste. Postimi mban datën 15 Mars 2023 si dhe provat bashkëlidhur dosjes.
- 2- Denoncimi regjistruar me nr. **188 ID -Kryetari i bashkisë Delvinë zj. Majlinda Qilimi**, në faqen e saj zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Delvinë”, ka postuar takimin e saj dhe të drejtuesit politik të qarkut Vlorë z. Blendi Klosi e deputetit të Partisë Socialiste zj. Anila Denaj, me strukturat e Partisë Socialiste. Postimi mban datën 15 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 3- Denoncimi regjistruar me nr. **189 ID - Kryetari i bashkisë Dibër z. Rahim Spahiu**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Dibër”, ka postuar takime të tij dhe të drejtuesit politik të qarkut Dibër znj. Belinda Balluku, me strukturat e Partisë Socialiste. Postimet mbajnë datat 11 e 5 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 4- Denoncimi regjistruar me nr. **190 ID - Kryetari i bashkisë Fier z. Armando Subashi**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, ka postuar takimin e tij dhe të drejtuesit politik të qarkut Fier z. Taulant Balla, me një grup njerëzish në Mbrostar. Teksti që shoqëron postim ka përmbajtje elektorale dhe sloganet e Partisë Socialiste. Postimi mban datën 19 Shkurt 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 5- Denoncimi regjistruar me nr. **191 ID - Kryetari i bashkisë Fushë-Arrëz, z. Fran Tuci**, në faqen e tij zyrtare në Facebook “Fran Tuci – Faqja Zyrtare” ka postuar materiale partiake e elektorale të Partisë Socialiste. Postimet mbajnë datat 13, 15 dhe 16 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 6- Denoncimi regjistruar me nr. **192 ID - Kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë”, ka postuar foto të aktiviteteve të kryera nga Partia Socialiste. Postimet mbajnë datat 21 Shkurt 2023 dhe 13 dhe 15 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

- 7- Denoncimi regjistruar me nr. **193 ID - Kryetari i bashkisë Gramsh z. Klodian Taçe**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Klodian Taçe”, ka postuar foto të aktivitetit të Partisë Socialiste. Postimi mban datën 12 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 8- Denoncimi regjistruar me nr. **194 ID - Kryetari i bashkisë Himarë z. Jorgo Goro**, në faqen e tij zyrtare në Facebook “Jorgo Goro për Himarën”, në të cilën citohet “Jorgo Goro, Kryetar i bashkisë Himarë (2011-2015-2019-2023) - Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka publikuar së paku një postim të aktivitetit të Partisë Socialiste, takim me drejtuesit politik të qarkut z. Blendi Klosi dhe deputetin z. Vullnet Sinaj. Postimi mban datën 11 mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 9- Denoncimi regjistruar me nr. **195 ID - Kryetari i bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Kamëz”, ka publikuar së paku dy postime të aktivitetit të Partisë Socialiste, takime me të deleguarën politike znj. Lindita Nikolla. Postimet mbajnë datat 17 Shkurt dhe 4 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 10- Denoncimi regjistruar me nr. **196 ID - Kryetari i bashkisë Klos z. Ilmi Hoxha**, në faqen e tij zyrtare në Facebook “Ilmi Hoxha Faqja Zyrtare”, në të cilën citohet “Kjo është Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë e cila menaxhohet nga stafi”, ka publikuar së paku dy postime të aktivitetit të Partisë Socialiste, takime me drejtuesin politik të qarkut Dibër znj. Belinda Balluku. Postimet mbajnë datët 25 Shkurt dhe 3 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 11- Denoncimi regjistruar me nr. **197 ID - Kryetari i bashkisë Kurbin, zj. Majlinda Cara**, në faqen e saj zyrtare në Facebook “Majlinda Shqalsi Cara”, në të cilën paraqitet si “Kryetare e Bashkisë Kurbin”, ka publikuar së paku gjashtë postime të aktivitetit të Partisë Socialiste, takime me drejtuesin politik të qarkut Lezhë z. Ulsi Manja, si dhe me shtabet e forumet e Partisë Socialiste. Postimet mbajnë datat 15 e 14 Mars, si dhe 24, 17, 15 dhe 3 Shkurt 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 12- Denoncimi regjistruar me nr. **198 ID - Kryetari i Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu**, në Faqen e tij Zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i Bashkisë Lezhë”, ka publikuar së paku dy postime të aktivitetit të Partisë Socialiste, takim me të drejtuesin politik të qarkut Lezhë z. Ulsi Manja dhe forumet e PS. Postimet mbajnë datat 12 Mars dhe 21 Shkurt 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.
- 13- Denoncimi regjistruar me nr. **199 ID “Kryetari i bashkisë Mat, z. Agron Malaj**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Mat”, ka publikuar së paku 9

(nëntë) postime të aktivitetit të Partisë Socialiste, takime me drejtuesin politik të qarkut Dibër zj. Belinda Balluku, si dhe me forumet e PS. Postimet mbajnë datat 11, 10 e 2 Mars dhe 28, 27, 26, 18 e 11 Shkurt, si dhe 29 Janar 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

14- Denoncimi regjistruar me nr. **200 ID - Kryetari i bashkisë Memaliaj, z. Gjolek Guci**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Memaliaj, qarku Gjirokastër” ka publikuar së paku dy postime të aktivitetit të Partisë Socialiste, takim me drejtuesin politik të qarkut Gjirokastër zj. Mirela Kumbaro e mbledhje të forumeve të PS. Postimet mbajnë datat 11 Mars dhe 29 Janar 2023, të regjistruara me nr. **200 ID** dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

15- Denoncimi regjistruar me nr. **201 ID -Kryetarja e bashkisë Patos, zj. Rajmonda Balilaj**, në Faqen e saj Zyrtare në Facebook “Rajmonda Balilaj” ka publikuar së paku dy postime të aktivitetit të Partisë Socialiste, postim të drejtuesin politik të qarkut Fier z. Taulant Balla për forumin e PS, si dhe postim mbi FRESSH. Postimet mbajnë datat 1 Mars e 15 Janar 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

16- Denoncimi regjistruar me nr. **202 ID - Kryetarja e bashkisë Përmet, zj. Alma Hoxha**, në Faqen e saj Zyrtare në Facebook, në të cilën citohet “Faqja Zyrtare e zj.Alma Hoxha, Kryetare e Bashkisë Përmet prej vitit 2019”, ka publikuar së paku dy postime të takimeve të strukturave të Partisë Socialiste, me drejtuesin politik të qarkut Gjirokastër znj. Mirela Kumbaro. Postimet mbajnë datat 12 mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

17- Denoncimi regjistruar me nr. **203 ID - Kryetari i bashkisë Sarandë, z. Adrian Gurma**, në Faqen e tij Zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Sarandë”, ka publikuar foto të një takimi të strukturave të Partisë Socialiste me drejtuesin politik të qarkut Vlorë z. Blendi Klosi dhe Deputeten znj. Anila Denaj. Postimi mban datën 15 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

18- Denoncimi regjistruar me nr. **204 ID - Kryetari i bashkisë Shkodër z. Bardh Spahia**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Shkodër”, ka publikuar foto nga aktiviteti me anëtarë e forume të Partisë Demokratike. Postimet mbajnë datat 14 Mars e 28 Shkurt 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

19- Denoncimi regjistruar me nr. **205 ID - Kryetari i bashkisë Tropojë z. Rexh Byberi**, në Faqen e tij Zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Tropojë”, ka postuar një takim me shtabin elektoral të Partisë Socialiste në Tropojë. Postimi mban datën 13 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

20- Denoncimi regjistruar me nr. **206 ID - Kryetari i bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj**, në faqen e tij zyrtare në Facebook, në të cilën paraqitet si “Kryetar i bashkisë Tiranë”, ka publikuar së paku 5 postime mbi aktivitetet e Partisë Socialiste. Postimet mbajnë datat 13, 6, 5 dhe 4 Mars 2023 dhe bashkëlidhur gjenden materialet provuese.

Pas verifikimit të kryer, u vlerësua se postimet në **llogaritë personale**, në rrjetin social “facebook” të kryetarëve të bashkisë, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Kryetari i bashkisë është mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit.

Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale nga ana e funksionarëve publik. Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përligjura.

Marrëdhëniet personale apo postimet në llogaritë personale në rrjetin social “facebook” të kryetarit të bashkisë, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore sic janë liria për tu shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. Kryetarët e bashkive nuk zhvishen nga e drejta e tyre private për të shprehur lirshëm bindjet politike, kjo sidomos në rrjetet e tyre sociale.

Në çdo rast tjetër, në kushtet ku objekt i shqyrtimit janë postimet nga llogaritë zyrtare në mediat sociale të institucioneve publike, postimet mund të shërbejnë si indicie për hetim, por gjithmonë në rast se ka mjaftueshëm të dhëna se veprimtaria publike është shfrytëzuar për thirrje elektorale.

Megjithatë jo çdo veprimtari e kryer nga kryetari dhe e postuar prej tij duhet të konsiderohet si veprimtari e institucionit. Të ndodhur në këto kushte, vlerësoj se veprimtaritë e mësipërme, nuk janë veprimtari që kanë pasur detyrimin për raportim pasi janë qartazi veprimtari politike.

Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 19 Prill 2023 Nr: 389
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, ndaj kryetarëve të disa bashkive, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj:
 - a. Kryetari i bashkisë Cërrik, z. Andis Salla;
 - b. Kryetari i bashkisë Delvinë, zj. Majlinda Qilimi;
 - c. Kryetari i bashkisë Dibër, z. Rahim Spahiu;
 - d. Kryetari i bashkisë Fier, z. Armando Subashi;
 - e. Kryetari i bashkisë Fushë-Arrëz, z. Fran Tuci;
 - f. Kryetari i bashkisë Gjirokastër, z. Flamur Golemi;
 - g. Kryetari i bashkisë Gramsh, z. Klodian Taçe;
 - h. Kryetari i bashkisë Himarë, z. Jorgo Goro;
 - i. Kryetari i bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli;
 - j. Kryetari i bashkisë Klos, z. Ilmi Hoxha;
 - k. Kryetari i bashkisë Kurbin, zj. Majlinda Cara;
 - l. Kryetari i bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu;
 - m. Kryetari i bashkisë Mat, z. Agron Malaj;
 - n. Kryetari i bashkisë Memaliaj, z. Gjolek Guci;
 - o. Kryetari i bashkisë Patos, zj. Rajmonda Balilaj;
 - p. Kryetar i bashkisë Përmet, zj. Alma Hoxha;
 - q. Kryetari i bashkisë Sarandë, z. Adrian Gurma;
 - r. Kryetari i bashkisë Shkodër, z. Bardh Spahia;
 - s. Kryetari i bashkisë Tropojë, z. Rexh Byberi;
 - t. Kryetari i bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 19 Prill 2023 Nr: 389
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, ndaj kryetarëve të disa bashkive, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”